

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE  
NR. 5269 REP.  
NR. 377 KOL.



AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
“TBI Consulting” Sh.p.k.

“TBI Consulting” Sh.p.k, perfaqesuar nga administratori i shoqerise Znj. **Ketrin Topçiu**

Ne Tirane, sot me date 13.11. 2006, perpara meje, A. Kekaj, noter i Dhomës se Notereve Tirane, u paraqiten personalisht personat:

**Artan BOZO**, person me shtetesi shqiptare, i datelindjes 28/8/1969, me adresë banimi Rruga “Ndre Mjeda” Pall 5/5 Tirane, Shqiperi. Mbajtes i Pasaportes me Nr Z 0772452

**Olsi IBRO**, person me shtetesi shqiptare, i datelindjes 1/3/1978, me adresë banimi Rruga “Margarita Tutulani” Pall 8/ap 32, Tirane, Shqiperi. Mbajtes i Pasaportes me Nr Z 0317520.

**Ismail KADIU** person me shtetesi shqiptare, i datelindjes 26.3.1961, lindur ne Vlore dhe banues ne adresen Bulevardi Zhan D’Ark, Kulla Nr.2, Ap.19, Tirane, Shqiperi. Mbajtes i Pasaportes me Nr Z 1560583;

**Ketrin TOPÇIU**, person me shtetesi shqiptare, i datelindjes 12/11/1968, me adresë banimi, Rruga Ndre Mjeda Pall 5/5, Tirane, Shqiperi. Mbajtes i leternjoftimit NF Nr. 475429.

te cilet, me zotesi te plote juridike per te vepruar, ne pranine time, nenshkruan kete Akt Themelimi te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **“TBI Consulting” Sh.p.k.**

**Neni 1**

**Forma e shoqerise**

Ortaket themelojne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, ne kuptimin qe pergjegjesia e secilit prej ortakeve eshte e kufizuar deri ne shumen e kapitalit te derdhur, pa iu njojur asgne pergjegjesi tjeter.

**Neni 2**

**Emertimi i shoqerise**

Emertimi i shoqerise eshte **“TBI Consulting” Sh.p.k.**

**Neni 3**

**Baza juridike**

Shoqeria e ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me legjisacionin shqiptar dhe ne perputhje me dispozitat e Statutit e Aktit te Themelimit.

#### Neni 4

##### Objekti i veprimtarise

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te perfshije:

Veprimtaria e Shoqerise "TBI" Consulting" Sh.p.k, do te ketë për objekt sherbimet e konsulences ligjore dhe financiare ne fushat e meposhtme:

- a) Konsulence ligjore per Personat Juridike dhe personat fizike;
- b) Konsulence ne fushen e tatim-taksave;
- c) Konsulence dhe shërbime financiare dhe te kontabilitetit; marketing; finance; menaxhim;
- d) Konsulence dhe shërbime profesionale Auditimi;
- e) Konsulence ne fushën e ndërtimit dhe te urbanistikës;
- f) Konsulence ne fushen industriale; energjetike; ne fushen e hidrokarbureve dhe nenprodukteve te tjera;
- g) Konsulence lidhur me sistemin bankar, sistemin e sigurimeve e risigurimeve, tregun e kapitaleve, bonove te thesarit, letrave me vlore;
- h) Konsulence lidhur me fushen e investimeve; turizmit;
- i) Konsulence lidhur me tregun e pasurive te paluajtshme; keshillime dhe perpilime te kontratave civile te parashikuara nga legjislacioni civil ne fuqi;
- j) Konsulence lidhur me legjislacionin dhe rregullat e prokurimeve publike;
- k) Konsulence ne lidhje me fushen e mediave;
- l) Konsulence biznesi, studime mundshmerie, konsulence ne perpilimin e planit te biznesit per shoqeri tregtare dhe OJF-te, informacion biznesi, mbeshtetje e plete ne procedurat ligjore te rregjistrimit per kompani shqiptare dhe te huaja, konsulence dhe mbeshtetje e plete per organizata donatore;
- m) Konsulence dhe kryerje e researcheve, kerkimeve te tipeve te ndryshme;
- n) Konsulence dhe këshillime specifike për ndërveprimin midis shoqërisë civile dhe qeverisjes vendore, për projekt-propozime dhe informacion mbi mundesite per financime dhe fonde;
- o) Konsulence per mbështetjen e krijimin e organizmave dhe strukturave ligjore te reja te shoqërisë civile;
- p) Konsulence dhe organizime te workshopave, kurseve te trainimit ne fushen ligjore; financiare; te marketingut; menaxhimit; ndermjetesimit; sherbimit me kliente;
- q) Konsulence lidhur me sistemin e standartizimit cilesor; konsultimit; auditimit dhe certifikimit;
- r) Konsulence ndaj anëtarëve dhe grupeve te tjera te interesuara, nëpërmjet kurseve te trajnimit, seminareve, konferencave, botimeve, punimeve studimore etj;

- s) Hapja e shkollave profesionale dhe e kurseve te trainimit ne fushat e mesiperme;  
t) Asistimi pranë qeverisë dhe institucioneve të tjera në formulimin e kuadrit ligjor, politikave tregtare bazuar në parimet dhe praktikat e zhvillimit të qëndrueshëm;

Shoqëria "TBI Consulting" Sh.p.k mund te kryeje cdo lloj veprin tarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, mund të kryejë cdo operacion prodhimi, tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj.

Shoqëria, me vendim të Administratorit, dhe pas miratimit paraprak të Asamblesë së Ortakëve, mund të lidhë marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo sipërmarrje të tjera, si dhe të kryejë cdo veprim tregtar që konsiderohet i nevojshëm me qëllim arritjen e objektit të veprin tarisë së saj.

Per te realizuar qellimet e saj Shoqeria mund te siguroje dhe perdore financime nga ortaket, nga vende te tjera ose nga institucione financiare vendase ose te huaja. Objekti i shoqerise mund te ndryshoje, te zgjerohet ose te pakesohet ne baze te vendimit te Asamblese te Ortakeve.

#### Neni 5

##### Selia

Selia e Shoqerise "TBI Consulting" Sh.p.k. eshte ne adresen: Bulevardi: "Zog i I-re", Qendra e Biznesit Veve, Tirane, Shqiperi.  
Shoqeria mund te hape dege dhe filiale brenda dhe/ose jashte vendit.

#### Neni 6

##### Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje veprin tarine per nje periudhe te pacaktuar kohore.

#### Neni 7

##### Kapitali i shoqerise

Kapitali themeltar i shoqerise "TBI Consulting" Sh.p.k eshte 100 000 (njeqind mijë) Leke, i ndare ne 100 pjesë me vlerë nominale prej 1.000 (nje mijë) leke secila. Kapitali i shoqerise eshte nenshkruar dhe derdhur plotesisht me te holla ne dore, respektivisht nga ortaket:

- Ortaku Artan BOZO, zoteron 25% pjesë te kapitalit themeltar qe i korrespondojne shumes prej 25 000 (njezetepese mijë) leke.
- Ortaku Olsi IBRO, zoteron 25% pjesë te kapitalit themeltar qe i korrespondojne shumes prej 25 000 (njezetepese mijë) leke.
- Ortaku Ismail KADIU , zoteron 25% pjesë te kapitalit themeltar qe i korrespondojne shumes prej 25 000 (njezetepese mijë) leke.
- Ortaku Ketrin TOPÇIU, zoteron 25% pjesë te kapitalit themeltar qe i korrespondojne shumes prej 25 000 (njezetepese mijë) leke.

#### Neni 8

##### Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga nje Administrator i Vetem.

Administratori i pare i shoqerise eshte Znj **Ketrin Topçiu**, shtetase shqiptare, lindur ne Tirane, Shqiperi , me 12/11/1968, Mbajtese e leternjoftimit NF Nr. 475429, banues ne

### Neni 8

#### Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga nje Administrator i Vetem.

Administratori i pare i shoqerise eshte Znj **Ketrin Topçiu**, shtetase shqiptare, lindur ne Tirane, Shqiperi , me 12/11/1968, Mbajtese e leternjoftimit NF Nr. 475429, banues ne Rruga "Ndre Mjeda", Pall 5/5, Tirane, Shqiperi.

Administratori do te qendroje ne detyre deri ne revokimin e mandatit nga Asambleja e Ortakeve. Administratori mban perjegjesi individuale perpara shoqerise ose te treteve per shkelje te ligjt dhe/ose te Statutit.

### Neni 9

#### Viti finanziar

Vitet financiare perputhen me vitin kalendarik. Viti finanziar fillon me 1 Janar dhe mballet me 31 Dhjetor te cdo viti kalendarik. Perjashtimisht, viti i pare finanziar do te filloje nga data e regjistrimit te shoqerise ne Registrin Tregtar dhe do te mballet ne fund te vitit perkates.

### Neni 10

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakeve themelues te shoqerise ne raport me kuotat e tyre ne kapitalin fillestar. Te ardhurat qe do te rezultojne ne fund te mbylljes se cdo ushtrimori, ne perputhje me parashikimet e statutit dhe pas pagimit te tatimeve, dhe rezerves se domosdoshme, te konkretizuara ne bilance, mund te ndahen ndermjet ortakeve ne raport me pjeset qe ata zoterojne ne kapitalin e shoqerise.

### Neni 11

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise, do te zgjidhen me mirekuptim. Ne rast te kundertet, kompetente per zgjidhjen e tyre jane Gjykatat Shqiptare.

Ky Akt themelimi i shoqerise me perjegjesi te kufizuar "**TBI Consulting**" Sh.p.k, eshte hartuar ne 5 kopje ne gjuhen Shqipe me fuqi te njejtë ligjore dhe te nenshkuara rregullisht nga ortaket themelues.

#### ORTAKET:

ARTAN BOZO

OLSI IBRO

ISMAIL KADIU

KETRIN TOPÇIU

*Artan Bozo Olsi Ibro*

NOTERI

LINDITA KOKONA  
TIRANE - SANTA

*Ketrin Topçiu*

# **STATUTI I SHOQERISE “TBI Consulting” Sh.p.k**



## **I.Dispozita te Pergjithshme**

### **NENI 1 Emertimi dhe Forma e Shoqërisë**

- 1.1 “TBI Consulting” Sh.p.k themelohet në formën e nje shoqerie me perjegjesi te kufizuar dhe aktiviteti i kesaj shoqerie do te rregullohet nga ky Statut dhe nga ligji nr. 7638, date 19.11.1992, “Per shoqerite tregtare”.
- 1.2. Emërtimi “TBI Consulting” Sh.p.k dhe emri i administratorit do të figurojnë në të gjitha aktet ose dokumentet e nxjerra nga shoqëria dhe që u drejtohen të tretëve.
- 1.3. Shoqeria “TBI Consulting” Sh.p.k e fiton personalitetin e saj juridik nga dita e rregistrit te saj ne Gjykate.

### **NENI 2 Dokumentat Rregullues**

- 2.1. Dokumenti kryesor mbi të cilin bazohet aktiviteti i Shoqërisë “TBI Consulting” Sh.p.k është Statuti i saj. Me ane te ketij Statuti dhe ne perputhje me Aktin e Themelimit dhe me legislacionin shqiptar, rregullohet pozita juridike e Ortakeve dhe punonjesve te Shoqërisë, organizimi dhe objekti i veprimtarise se Shoqërisë dhe çeshtjet e tjera me rëndësi pér aktivitetin e saj.
- 2.2 Per çeshtjet qe nuk zgjidhen nga Statuti, Asambleja e Ortakëve mund të miratojë një Rregullore të Veçantë.
- 2.3. Statuti dhe Rregullorja e Veçantë janë dokumenta të hapura pér ndryshime dhe përmirësimë që zhvillimet i bëjnë të nevojshme.

### **NENI 3 Ortaket**

- 2.1 Ortaket e “TBI Consulting” Sh.p.k jane:

**Artan BOZO**, person me shtetesi shqiptare, i datelindjes 28/8/1969, me adresë banimi Rruga “Ndre Mjeda” Pall 5/5 Tirane, Shqiperi. Mbajtes i Pasaportes me Nr Z 0772452.

**Olsi IBRO**, person me shtetesi shqiptare, i datelindjes 1/3/1978, me adresë banimi Rruga “Margarita Tutulani” Pall 8/ap 32, Tirane, Shqiperi. Mbajtes i Pasaportes me Nr Z 0317520.

**Ismail KADIU** person me shtetesi shqiptare, i datelindjes 26.3.1961, lindur ne Vlore dhe banues ne adresen Bulevardi Zhan D’Ark, Kulla Nr.2, Ap.19, Tirane, Shqiperi. Mbajtes i Pasaportes me Nr Z 1560583;

**Ketrin TOPÇIU**, person me shtetesi shqiptare, i datelindjes 12/11/1968, me adresë banimi, Rruga Ndre Mjeda Pall 5/5, Tirane, Shqiperi. Mbajtes i leternjoftimit NF Nr. 475429.

**NENI 4**  
**Selia**

4.1. Shoqeria "TBI Consulting" Sh.p.k e ka seline e saj ne adresen: Bulv: Zog i I-re, Qendra e Biznesit VEV, Tirane, Shqiperi.

Shoqeria vepron si person juridik shqiptar dhe si e tillë mund te kryeje aktivitetin e saj ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise ose jashtë saj, nepermjet filialeve, degeve, zyrave te perfaqesimit ose agjensite e saj, te cilat jane krijuar me vendim të Asamblesë së Ortakëve të Shoqerise dhe do te veprojne nen mbikqyrjen e Administratorit të "TBI Consulting" Sh.p.k.

4.1. Administratori mund të transferojë Selinë e Shoqërisë brenda qytetit të Tiranës.

**NENI 5**  
**Vula, Stema**

5.1. Shoqeria "TBI Consulting" Sh.p.k ka vulen e saj mbi te cilen ka te shkruar emertimin e saj.

5.2. Stema e "TBI Consulting" Sh.p.k duhet te figuroje ne te gjithe materialet prezantuese dhe shkresat zyrtare te Shoqërisë.

**NENI 6**  
**Kohezgjatja**

6.1. Shoqeria do te kryeje aktivitetin e saj per nje periudhe kohe te pacaktuar pervec kur vendoset ndryshe ne marreveshje ndermjet Ortakëve te saj.

**NENI 7**  
**Objekti i veprimitarisë së Shoqërisë**

7.1. Shoqeria "TBI Consulting" Sh.p.k ushtron veprimitarinë e saj me qëllim realizimin e fitimit, duke u mbështetur në parimet e likuiditetit, sigurisë dhe rentabilitetit, sipas rregullave të parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

7.2. Veprimitaria e Shoqërisë "TBI Consulting" Sh.p.k, do të ketë për objekt sherbimet e konsulences ligjore dhe financiare ne fushat e me poshtme:

- a) Konsulence ligjore per Personat Juridike dhe personat fizike;
- b) Konsulence ne fushen e tatim-taksave;
- c) Konsulence dhe shërbime financiare dhe të kontabilitetit; marketing; finance; menaxhim;

- d) Konsulence dhe sherbime profesionale Auditimi;
- e) Konsulence ne fushën e ndërtimit dhe të urbanistikës;
- f) Konsulence ne fushen industriale; energjitike; ne fushen e hidrokarbureve dhe nenprodukteve te tjera;
- g) Konsulence lidhur me sistemin bankar, sistemin e sigurimeve e risigurimeve, tregun e kapitaleve, bonove te thesarit, letrave me vlere;
- h) Konsulence lidhur me fushen e investimeve; turizmit;
- i) Konsulence lidhur me tregun e pasurive te paluajtshme; keshillime dhe perpilime te kontratave civile te parashikuara nga legjislacioni civil ne fuqi;
- j) Konsulence lidhur me legjislacionin dhe rregullat e prokurimeve publike;
- k) Konsulence ne lidhje me fushen e mediave;
- l) Konsulence biznesi, studime mundshmerie, konsulence ne perpilimin e planit te biznesit per shoqeri tregtare dhe OJF-te, informacion biznesi, mbeshtetje e pote ne procedurat ligjore te rregjistrimit per kompani shqiptare dhe te huaja, konsulence die mbeshtetje e pote per organizata donatore;
- m) Konsulence dhe kryerje e research eve te tipeve te ndryshme;
- n) Konsulence dhe këshillime specifike për ndërveprimin midis shoqërisë civile dhe qeverisjes vendore, për projekt-propozime dhe informacion mbi mundesite per financime dhe fonde;
- o) Konsulence per mbështetjen e krijimin e organizmave dhe strukturave ligjore të reja të shoqërisë civile;
- p) Konsulence dhe organizime te workshopeve, kurseve te trainimit ne fushen ligjore; finanziare; te marketingut; menaxhimit; ndermjetesimit; sherbimit me kliente;
- q) Konsulence lidhur me sistemin e standartizimit cilesor; konsultimit; auditimit dhe certifikimit;
- r) Konsulence ndaj anëtarëve dhe grupeve të tjera të interesuara, nëpërmjet kurseve të trajnimit, seminareve, konferencave, botimeve, punimeve studimore etj;
- s) Hapja e shkollave profesionale dhe e kurceve te trainimit ne fushat e mesiperme;
- t) Asistimi pranë qeverisë dhe institucioneve të tjera në formulimin e kuadrit ligjor, politikave tregtare bazuar në parimet dhe praktikat e zhvillimit të qëndrueshëm;

7.3. Shoqëria "TBI Consulting" Sh.p.k mund te kryeje cdo lloj veprimitarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, mund të kryejë cdo operacion prodhimi, tregtar dhe finanziar, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj.

7.4. Shoqëria, me vendim të Administratorit, dhe pas miratimit paraprak të Asamblesë së Ortakëve, mund të lidhë marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo sipërmarrje të tjera, si dhe të kryejë cdo veprim tregtar që konsiderohet i nevojshëm me qëllim arritjen e objektit të veprimitarisë së saj.

7.5. Shoqëria mund të ndryshojë objektin e veprimitarisë së saj, emërtimin dhe selinë, vetëm me marrëveshjen e Ortakëve të saj. Vendimi i Asamblesë së Ortakëve administrohet në përputhje me legjislacionin dhe rregjistrohet në Zyrën e Rregjistrat Tregtar dhe në Organet Tatimore.

7.6. Shoqëria "TBI Consulting" Sh.p.k do te ushtroje veprimitarine per ato aktivitete qe kerkojne marrjen e licensave dhe lejeve perkatese vetem pas marrjes se tyre nga organet

dhe strukturat e caktuara nga ligji. Shoqëria "TBI Consulting" Sh.p.k do te ushtroje veprimtarine në përbushje të objektit të veprimitarës së saj, duke zbatuar të gjithë ligjet dhe aktet nënligjore rregullues në lidhje me licencimin, kushtet, procedurat dhe afatet e kërkuar.

Gjatë kohëzgjatjes së aktivitetit të saj Shoqëria "TBI Consulting" Sh.p.k zbaton standartet më të larta të etikës profesionale dhe zbatimit të ligjshmërisë.

## II. KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESET E KAPITALIT THEMELTAR

### NENI 8 Kapitali themeltar

8.1. Vlera e Kapitalit Themeltar të Shoqërisë "TBI Consulting" Sh.p.k eshte 100 000 Leke.

8.2. Kapitali ndahet ne 100 pjesë te barabarta, secila me vlore perj 1000 leke, te nenshkruara dhe te shlyera plotesisht nga Ortakët. Ortakët zoterojne pjesët e Kapitalit Themeltar ne raportet e meposhtme:

**Artan BOZO** 25 pjesë të Kapitalit Themeltar

**Olsi IBRO** 25 pjesë të Kapitalit Themeltar

**Ismail KADIU** 25 pjesë të Kapitalit Themeltar

**Ketrin TOPÇIU** 25 pjesë të Kapitalit Themeltar

8.3. Kapitali depozitohet sipas nenit 40 te ligjit nr.7638, date 19.11.1992, "Per shoqerite tregtare".

8.4. Pjeset e Kapitalit Themeltar nuk materializohen ne letra me vlore te tregtueshme por vertetohen me ane te certifikatave nominative te leshuara nga shoqeria.

8.5. Çdo pjesë e kapitalit themeltar i jep te drejten e nje vote zoteruesit te saj.

8.6. Ortakët e Shoqerise "TBI Consulting" Sh.p.k per gjigjen per detyrimet ndaj te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne formimin e Kapitalit Themeltar të Shoqerise.

### NENI 9 Transferimi

9.1. Pjeset e kapitalit mund të transferohen lirisht ndërmjet ortakeve.

9.2. Transferimi i pjeseve te kapitalit tek persona te trete qe nuk bejne pjesë ne Shoqeri iu nenshtrohet ketyre rregullave:

a) Transferuesi ose Ortaku transferues, duhet tē njoftoje Ortaket e tjere për numrin e pjeseve qe do te transferohen, çmimin e shitjes ne rast shitjeje, si dhe emrin, mbiemrin dhe adresen e personit te cilit mendon t'i transferohen pjeset.

b) Transferimi duhet te miratohet nga Ortaket e tjere brenda 3 muajve nga dita e njoftimit. Ne rast se Ortaket nuk e kane bere te ditur vendimin e tyre brenda afatit 3 mujor. miratimi quhet i dhene.

c) Ne rast se Ortaket refuzojne transferimin, brenda 3 muajve nga data e refuzimit, atëherë ata duhet t'i blejne pjeset e propozuara per transferim. Çmimi i shitjes eshte vlera kontabel e pjeseve.

d) Ne rast se Ortaku nuk eshte i interesuar te bleje pjeset, atehere Ortakët e Shoqërisë do tē bien dakort nese:

1. pjeset do ti shiten personit te propozuar nga Ortaku transferues me cmimin e rene dakort midis tyre;
2. pjeset do ti shiten nje personi tjeter te trete me çmimin e rene dakort me kete person , por jo me pak se vlera kontabel e tyre;
3. pjeset do te blihen nga Shoqeria per tu anulluar, ne kuadrin e nje zvogelimi kapitali, ne perputhje me nenin 64 te ligjt nr.7638, date 19.11.1992, "Per shoqerite tregtare".
- 9.3. Pjesët e Kapitalit Themeltar janë lirisht të transferueshme ne rruge trashegimie, ne rast ndarjeje pasurie ndermjet bashkeshorteve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.
- 9.4. Asambleja e Ortakëve mund të vendosë që bashkëshorti, trashëgimtari, paraardhësi ose pasardhësi të bëhen ortakë, nëpërmjet transferimit të pjesëve të kapitalit themeltar, vetëm pasi të jetë miratuar nga Asambleja sipas kushteve që caktojnë Ortakët. Kushtet për ortakun e ri nuk mund të jenë më pak të favorshme se ato të caktuara për të tretët për rastet e transferimit të pjesëve të kapitalit themeltar, përndryshe Vendimi i Asamblesë është i pavlefshëm.
- 9.5. Transferimi i pjesave te kapitalit themeltar, ne çdo rast, duhet te vertetohet me akt notorial.

## **NENI 10 Zmadhimi i Kapitalit**

- 10.1. Kapitali themeltar mund te zmadhohet me vendim te ortakeve, ne perputhje me nenet 62 dhe 63 te ligjt nr.7638, date, 19.11.1992, "Per shoqerite tregtare", ne baze te raportit te Administratorit te Shoqerise.
- 10.2. Zmadhimi i kapitalit mund te kryhet me ane te kontributeve te reja ne para, me ane te kontributeve ne natyre ose me perfshirjen e rezervave dhe fitimit si pjesë të Kapitalit Themeltar.
- 10.3. Ortaket kane te drejten e rritjes ne menyre proporcionale të Kapitalit, pra ne te njejtën mase me pjeset e kapitalit qe ata perfaqesojne përparrë zmadhimit të Kapitalit. Asnjëri nga Ortakët nuk mund te favorizohet apo te defavorizohet nepermjet zmadhimit te kapitalit dhe në çdo rast duhet të zbatohet parimi i trajtimit te barabarte. Çdo Ortak mund te ushtroje kete te drejte, duke nenshkruar nje numer me te vogel të pjesëve të Kapitalit nga sa u takon sipas parimit te perpestueshmerise.
- 10.4. Ne rast zmadhimi te kapitalit me ane te kontributeve në para, te gjitha pjeset e reja të Kapitalit duhet te nenshkruhen dhe te shlyhen teresisht nga Ortakët. Ato duhet te depozitoohen nga nenshkruesit në Bankë per llogari te Shoqerise "**TBI Consulting Sh.p.k.**" Terheqja e fondeve te reja mund te behet vetem pas rregjistrimit te zmadhimit te kapitalit ne Rregjistrin Tregtar. Ne rast se zmadhimi i kapitalit nuk registrohet ne Rregjistrin Tregtar brenda 6 muajsh nga data e depozitimit te pare te fondeve, kontribuesit kane te drejte individualisht ose bashkarisht, te kerkojne ne rruge gjygesore autorizim per terheqjen e shumes se kontributeve te tyre.

## **NENI 11 Zvogelimi**

- 11.1. Zvogelimi i kapitalit deri ne nje vlere jo me te vogel se 100 000 leke mund te kryhet me vendim te ortakeve, ne perputhje me nenin 64 te ligjt nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare".

The bottom left corner of the page contains three handwritten signatures in black ink. The first signature on the left is a stylized 'BZ'. The second signature in the middle is a stylized 'MM'. The third signature on the right is a stylized 'J'.

The bottom right corner of the page contains a handwritten signature in black ink, which appears to be a stylized 'J' or 'G'.

11.2. Zvogelimi i prek Ortaket ne te njejt mase ndaj pjeseve te kapitalit qe ata zoterojne.

11.3. Ne rast se kapitali i shoqerise, per shkak te humbjeve te konstatuara ne dokumentat financiare, rezulton me i vogel se gjysma e kapitalit themeltar, brenda kater muajve nga miratimi i llogarive qe pasqyrojne keto humbje, ortaket duhet te vodosin ose prishjen e shoqerise, ose zvogelimin e kapitalit me nje vlere me te madhe se ajo e humbjeve qe kane mbetur te pambuluara nga rezervat, por pa e zbritur kapitalin nen shumen 100 000 Leke, ne perputhje me nenet 72 dhe 38, Ligji nr. 7638, date. 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare".

### **III. MARRJA E VENDIMEVE , ADMINISTRIMI, DHE KONTROLLI I SHOQERISE**

#### **NENI 12 Organet drejtuese**

12.1. Organet drejtuese të Shoqerisë "**TBI Consulting**" Sh.p.k. janë:

- a) Asambleja e Ortakeve në të cilën marrin pjesë Ortakët e Shoqërisë ose përfaqësuesit e tyre të pajsur më prokurë të veçantë; dhe
- b) Administratori ose Administratorët në rastet kur Ortakët kanë vendosur që Shoqëria të administrohet nga disa Administratorë.

#### **NENI 13 Asambleja e Ortakeve dhe konsultimet ndermjet Ortakeve**

13.1. Vendimet merren nga Asambleja e Ortakeve. Asambleja e Ortakeve merr vendime per ceshtjet qe ligji apo ky statut ia rezervon ketij organi, si dhe per ceshtjet per te cilat, Administratori kerkon mendimin apo miratimin e Asamblesë së Ortakeve.


13.2. Vendimet e Asamblesë së Ortakeve merren me shkrim dhe regjistrohen ne nje register te posacem te mbajtur prane selise se Shoqerise "**TBI Consulting**" Sh.p.k.

13.3. Perveç rasteve të miratimit të llogarive vjetore si dhe ndryshimeve të Statutit, Asambleja mund te marre vendime edhe me ane te konsultimit me shkrim te ortakeve. Administratori ka të drejtën e zgjedhjes së formës së marrjes së vendimit ndërmjet mbledhjes së Asamblesë ose konsultimit me shkrim. Konsultimi me shkrim mund të kryhet ne kete menyre:

- a. Administratori harton nje propozim me shkrim te projektvendimit qe kerkon te aprovohet;
- b. Administratori iu dergon te gjithe ortakeve, propozimin me shkrim te vendimit me ane te nje letre rekomande , poste te rregjistruar ose faxi, si dhe dokumentet e nevojshme për informimin e tyre;
- c. Ortaket brenda 15 ditëve, kthejne nje pergjigje ekzakte nese miratojne apo refuzojne propozimin e vendimit, me ane te nje letre rekomande, poste te rregjistruar ose te nje faxi;
- d. Administratori mbledh miratimet dhe refuzimet dhe iu dergon te gjithe ortakeve rezultatin e votimit, me ane te nje letre rekomande, poste te rregjistruar ose faxi;
- e. çdo ortak ka te drejte ti kerkoje Administratorit te kontrolloje procesin e konsultimit me shkrim.

13.4. Administratori për të gjithë konsultimet me shkrim të zhvilluara me ortakët mban proces-verbale të veçantë në të cilët përshkruhen:

- a. modalitetet e konsultimit për secilin ortak, data e lajmërimit dhe dërgimit të dokumenteve, afati i përgjigjes etj;



- b. dokumentet dhe raportet e dërguara për secilin ortak;
- c. teksti i projektvendimit që propozohet të miratohet;
- d. përgjigjet e ortakëve në lidhje me miratimin ose jo të projektvendimeve;
- e. si dhe çdo e dhënë tjetër në lidhje me procesin e konsultimit me shkrim.

13.5. Çdo mbledhje e Asamblesë e thirrur në mënyrë të parregullt, si dhe çdo konsultim me shkrim i kryer në mënyrë të parregullt, mund të anulohet. Megjithatë anulimi nuk ka vlerë, në rast se të gjithë ortakët kanë qenë të pranishëm ose të përfaqësuar si dhe kanë miratuar projektvendimin e propozuar.

#### **NENI 14** **Marrja e vendimeve**

14.1. Çdo ortak, pavarësisht nga numri i pjesëve të kapitalit që zoteron, ka te drejte te marrë pjese ne mbledhjet dhe ne vendimet e asamblese dhe disponon një numer votash te barabarte me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron.

14.2. Kur Asambleja e Ortakëve është thirrur për të marrë një vendim për një marrëveshje midis Shoqërisë dhe Ortakut, ky i fundit nuk mund të marrë pjesë në votim dhe vendimi merret nga Ortaku ose Ortakët e tjerë të Shoqërisë.

14.3. Çdo ortak ka te drejte te perfaqesohet ne keto mbledhje nga një ortak tjeter ose nga një mandatmbajtes i cili mund te votoje ne emer te atij qe perfaqeson. Mandati i përfaqësimit nuk mund të jetë i përhershëm, por jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë. Mandati i dhënë për një mbledhje të Asamblesë është i vlefshëm për mbledhjet e tjera, që thirren si vazhdim i së parës dhe me të njëjtin rend dite.

14.4. Në mbledhjet e Asamblesë ose në konsultimet me shkrim vendimet merren nga një ose disa ortakë që përfaqësojnë më shumë se gjysmën e pjesëve të kapitalit themeltar. Në rast se nuk sigurohet kjo shumicë, ortakët konsultohen për herë të dytë dhe vendimet merren me shumicën e votave të dhëna, pavarësisht nga përqindja e kapitalit që ato përfaqësojnë.


#### **Neni 15** **Zhvillimi i mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve**

15.1. Asambleja e Ortakëve i zhvillon mbledhjet ne seline e Shoqerise ose ne një vend tjeter te caktuar nga vete Ortakët.

15.2. Asambleja mblidhet ne menyre te rregullt jo me pak se dy herë në vit, dhe njëra prej mbledhjeve zhvillohet brenda një afati prej 6 muajsh nga dita e mbylljes se vitit financiar. Asambleja mund te thirret ne çdo kohe me kerkesen e:

- a. një apo disa ortakeve qe perfaqesojnë jo më pak se 10% te pjesëve te kapitalit themeltar,
- b. ekspertit kontabel te autorizuar. Përpara se të thérresë Asamblenë, eksperti kontabël i autorizuar njofton administratorin me letër rekomande.;
- c. te administratorit. Në qoftë se janë disa administratorë, e drejta e thirrjes së Asamblesë mund t'i besohet ose secilit administrator ose të gjithë administratorëve që të veprojnë bashkarisht.;
- d. te likujdusit.

15.3. Administratori iu njofton me leter rekomande, te gjithe ortakeve mbledhjen e Asamblese, te pakten 15 dite perpara mbledhjes. Lajmerimi permban daten, adresen dhe rendin e dites se mbledhjes. Duke filluar nga data e komunikimit, çdo ortak ka të drejtë të paraqesë pyetje me shkrim, të cilave Administratori duhet t'u përgjigjet në mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve.



15.4. Kur Administratori ose eksperti kontabël i autorizuar kanë refuzuar të mbledhin Asamblenë, secili nga Ortakët mund t'i drejtohet Gjykatës për caktimin e një mandatmbajtësi të ngarkuar për thirrjen e Asamblesë së Ortakëve.

15.5. Asambleja drejtohet nga Administratori ose nga Ortaku që zoteron ose përfaqëson numrin më të madh të pjesëve të Kapitalit. Nëqoftëse dy Ortakë zoterojnë të njëjtin numër pjesësh, drejtimi i mbledhjes bëhet nga Ortaku më i moshuar. Kompetencat, te drejtat dhe detyrimet e Kryetarit të Asamblesë ndaj Shoqerise, rregullohen ne aktin e emerimit të tij.

15.6. Kryetari i Asamblese emeron një person fizik, ortak ose jo, ne postin e sekretarit. Sekretari mbën proces-verbalin e mbledhjes, i cili firmoset nga te gjithe ortaket e pranishem ne mbledhje.

15.7. Proçes-verbal i mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve do te permbate sa me poshtë vijon:

- a. Datën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes;
- b. Menyren e njoftimit;
- c. Kryetarin e Asamblesë dhe Sekretarin;
- d. Rendin e dites;
- e. Numrin dhe emrat e pjesëmarrësve;
- f. Raportet dhe dokumentet qe jane paraqitur ne mbledhje;
- g. Permbledhjen e diskutimeve të zhvilluara;
- h. Numrin e votave bazuar në pjesët e Kapitalit Themeltar;
- i. Tekstet e projekt-vendimeve te votuar, ata te miratuar dhe ata te hedhur poshtë nga Ortakët.

15.8. Votimi kryhet i veçantë për çdo projektvendim dhe nëqoftëse një projektvendim përmban shumë çështje që secila mund të kërkojë një votim të veçantë, atëherë çdo ortak mund të kërkojë ndarjen e projektvendimit në disa projektvendime të veçantë.

15.9. Votimi eshte ne parim i hapur, por mënyra e votimit përcaktohet në marrëveshje ndërmjet ortakëve. Me kerkese te nje ose disa ortakeve qe perfaqesojne me shume se gjysmen e pjeseve te kapitalit, votimi zhvillohet i fshehtë.

15.10. Te gjitha vendimet e shoqerise registrohen ne nje liber te veçante qe mbahet ne seline e Shoqerise, i cili duhet te jetë i numërtuar dhe i vulosur.

### **Neni 16** **Kompetencat e Asamblesë së Ortakëve**

16.1. Jane ne kompetencen ekskluzive te Asamblese së Ortakëve marrja e vendimeve per sa i perket:

- a. ndryshimit të Statutit;
- b. riorganizimi i shoqerise, ndarja, bashkimi, likujdimi;
- c. linjat baze per zhvillimin e aktivitetit te Shoqerise;
- d. zmadhimi, zvogelimi i kapitalit, transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar tek të tretët, si dhe blerjen e pjeseve te kapitalit themeltar nga vete shoqeria me qellim anullimin e tyre;
- e. miratimi i llogarive, raportit vjetor, inventaret, rapporti i eksperteve kontabel te autorizuar;
- f. hapja e filialeve, degeve apo zyrave te reja;
- g. marrja hua, lenja peng apo çdo barre tjeter siguruese;
- h. hapja e nje aktiviteti te ri ekonomik;
- i. emerimi dhe shkarkimi i Kryetarit te Asamblese;
- j. emerimi dhe shkarkimi i Administratorit;



- k. emerimi dhe shkarkimi i eksperteve kontabel te autorizuar;
- l. blerja e pasurive te paluajtshme;
- m. blerja e aksioneve, certifikatave apo tituve te shoqerive te tjera tregtare, apo e çdo lloj instrumenti financiar;
- n. Prishjen e shoqerise ne rast se humbjet jane me te medha se gjysma e kapitalit;
- o. Shnderimin e Shoqerise në një formë tjeter;
- p. si dhe te gjitha kompetencat e tjera qe ligji dhe/ose ky Statut i jepin shprehimisht Asamblese.

16.2. Për çështjet e mësipërme, Asambleja e Ortakëve do të marrë vendim me unanimitet derisa Ortakët t'ë kenë vendosur transferimin tek të tretët të pjesëve të Kapitalit Themeltar. Pas transferimit të Kapitalit tek të tretët për një nga shkaqet ligjore, Asambleja e Ortakëve do të marrë vendime me shumice te zakonshme ose shumice te jashtezakonshme sipas parashikimeve të ligjit nr. 7638, date 19.11.1992, "Per shoqerite tregtare".

16.3. Çdo marrëveshje ndërmjet Shoqërisë "**TBI Consulting**" Sh.p.k. dhe Administratorit ose njërit prej Ortakëve, qoftë e drejtpërdrejtë ose jo e drejtpërdrejtë, duhet t'i nënshistrohet autorizimit paraprak të Asamblesë së Ortakëve. Kjo dispozitë është e zbatueshme edhe për marrëveshjet ndërmjet Shoqërisë "**TBI Consulting**" Sh.p.k. dhe një shoqërie tjeter, kur një Ortak është edhe Ortak apo Aksioner i shoqërisë tjeter, me të cilën propozohet të lidhet marrëveshja. Parashikimi i mësipërm nuk është i zbatueshëm për marrëveshjet që kanë të bëjnë me veprimet operacionale-rrjedhëse të Shoqërisë "**TBI Consulting**" Sh.p.k që kryhen në kushtet normale.

#### **NENI 17** **Administratori i Shoqërisë**

17.1. Shoqeria administrohet nga Administratori, një person fizik qe mund te jete ose jo ortak i Shoqerise.

17.2. Administratori është i detyruar të drejtojë Shoqerinë "**TBI Consulting**" Sh.p.k. në përputhje me ligjin « Për Shoqëritë Tregtare », këtë Statut, vendimet e Asamblesë së Ortakëve dhe sipas dispozitave të tjera ligjore në fuqi.


17.3. Ne rastet kur Administratori është Ortak i Shoqërisë "**TBI Consulting**" Sh.p.k. në baze te nenit 5 te Kodit Shqiptar te Punes, detyra e Administratorit nuk do të regullohet nga kontrata e punes.

17.4. Administratori i Shoqërisë "**TBI Consulting**" Sh.p.k. nje here ne tre muaj, duhet t'i paraqese Asamblesë së Ortakëve, per kontroll dhe verifikim, raportin mbi administrimin e Shoqerise.

17.5. Administratori i Shoqërisë "**TBI Consulting**" Sh.p.k brenda tre muajve nga mbyllja e viti financiar te Shoqerise, duhet t'i paraqese Asamblesë së Ortakëve per kontroll dhe verifikim, raportin financiar vjetor dhe bilancin e Shoqerise.

17.6. Administratori përgatit gjithashtu edhe raportin e administrimit për gjendjen e shoqërisë gjatë viti financiar të kaluar, ndryshimet e parashikuara për të ardhmen, ngjarjet më të rëndësishme që kanë ndodhur gjatë periudhës nga data e mbylljes së viti financiar deri në datën e hartimit të këtij reporti.

17.7. Administratori duhet t'i transmetoje Asamblesë së Ortakëve te gjithe korrespondencen e mbajtur me Ekspertet Kontabel te Autorizuar te Shoqerise.



**NENI 18**  
**Emërimi dhe shkarkimi i Administratorit**

18.1. Administratori i Shoqerise emerohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Ortakëve, si dhe do te qendroje ne detyre per një kohë të pacaktuar.

18.2. Administratori i parë i Shoqërisë "**TBI Consulting**" Sh.p.k emerohet me miratimin e Ortakeve në Aktin e Themelimit të Shoqërisë.

18.3. Kohëzgjatja e mandatit të Administratorit mund të përcaktohet nga Ortakët sa herë që bëhet emërimi i Administratorit dhe do të parashikohet në aktin e emërimit. Në mbarim të afatit të parashikuar, Administratori mund të riemërohet. Në mungesë të parashikimeve kohore në aktin e emërimit, Administratori do të ushtrojë detyrat e tij për të gjithë periudhen e aktivitetit të Shoqërisë.

18.4. Administratori i Shoqërisë "**TBI Consulting**" Sh.p.k mund te shkarkohet para perfundimit te mandatit ne rastet e meposhtme:

a. Nese është shpallur fajtor me vendim te formes se prere te gjykates per kryerjen e nje vepre penale që ka lidhje me veprimtarine ekonomiko-financiare;

b. Nese vertetohet se ka shperdoruar fondet e Shoqerise;

c. Ne rast se me vendim te gjykates kompetente i eshte kufizuar apo hequr zotesia per te vepruar;

d. Nese është ndaluar për të administruar dhe drejtuar shoqëritë;

e. Në çdo rast tjetër që pengon në mënyrë të zgjatur Administratorin të kryejë funksionet e tij;

f. Si dhe për çdo arsyet që vlerësohet nga Asambleja e Ortakëve.

18.5. Konsiderohet arsyet e drejtë për shkarkimin e Administratorit:

a. refuzimi i vazhdueshëm i Administratorit për t'u nënshtruar rregullave të ligjit dhe dispozitive të Statutit lidhur me miratimin vjetor të llogarive dhe me të drejtën e ortakëve për t'u informuar;

b. administrimi i keq financiar i Shoqërisë "**TBI Consulting**" Sh.p.k;

c. pavarësisht nga gabimet e Administratorit, do të konsiderohet arsyet e drejtë për shkarkimin e Administratorit fakti i humbjes së besimit dhe marrëdhëniet jo të mira me Ortakët, bankierët dhe Administratën publike;

d. Administratori ka ndjekur një politikë personale në administrimin e Shoqërisë dhe nuk ka pranuar sugjerimet e vazhdueshme të Ortakëve për mirëadministrimin e Shoqërisë.

18.6. Në rast se shkarkimi i Administratorit është bërë pa arsyet e drejtë, atëherë ai mund të kërkojë nga Gjykata caktimin e dëmshpérblimit financiar.

18.7. Edhe nëse është marrë pa një arsyet e drejtë, Vendimi për shkarkimin e Administratorit nuk mund të kundërshtohet në Gjykatë nëqoftëse janë zbatuar rregullat e kërkuar nga ligji për shumicën e kërkuar. Në një rast të tillë, Gjykata mund të vendosë vetëm për dëmshpérblimin financiar të Administratorit të shkarkuar.


18.8. Me kërkësë të çdonjërit prej Ortakëve të Shoqërisë "**TBI Consulting**" Sh.p.k.

Administratori mund të shkarkohet nga Gjykata për shkelje të ligjit ose të Statutit.

18.9. Efektet e Vendimit për shkarkimin e Administratorit fillojnë nga data e marrjes së tij dhe vendimi nuk mund të ketë fuqi prapavepruese.

**NENI 19**  
**Dorëheqja e Administratorit**

19.1. Administratori qoftë Ortak ose jo, mundet në çdo kohë të japë dorëheqjen, por nëse dorëheqja bëhet pa arsyet e drejtë, Shoqëria "**TBI Consulting**" Sh.p.k mund të kërkojë dëmshpérblim financiar në masën që është dëmtuar nga kjo dorëheqje.



19.2. Administratori që kërkon të japë dorëheqjen duhet të njoftojë me letër rekomande me kthim përgjigje Administratorët e tjerë si dhe të gjithë Ortakët.

19.3. Njostimi i dorëheqjes e bën dorëheqjen përfundimtare dhe Administratori nuk mund të rimarrë funksionet e tij.

## **NENI 20** **Kompetencat e Administratorit**

20.1. Administratori ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet ne emer dhe per interes te Shoqerise "**TBI Consulting**" Sh.p.k me perjashtim te atyre kompetencave që ligji dhe/ose ky Statut i jepin shprehimisht Asamblese së Ortakëve.

20.2. Administratori ka te drejte te perfaqesoje Shoqerine para te treteve dhe te gjitha vendimet manazheriale te Shoqerise "**TBI Consulting**" Sh.p.k duhet te nenshkuhen te pakten nga Administratori.

20.3. Asambleja e Ortakëve mund t'i japë autorizim paraprak Administratorit për kryerjen e operacioneve të caktuara ose lidhjen e kontratave të cilat konsiderohen tepër të rëndësishme për Shoqërinë.

20.4. Megjithatë, pa përjashtuar masa të tjera më të detajuara dhe rregullore të brendshme të Shoqërisë, veprimet dhe kompetencat e mëposhtme Administratori mund t'i kryejë vetëm me autorizim paraprak të Asamblesë së Ortakëve:

a. përcaktimi dhe ndryshimi i programit të veprimitarë afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë të Shoqërisë "**TBI Consulting**" Sh.p.k ;

b. kryerja e investimeve dhe financimeve për vitin finanziar si dhe veprimet apo operacionet e tjera që do të kërkonin ndryshimin e buxhetit fillestar të Shoqërisë;

c. hapja e veprimitarive ose e njësive të reja, shkrirja ose bashkimi dhe mbyllja tërësisht a pjesërisht e veprimitarive dhe njësive të Shoqërisë;

d. blerja, shkëmbimi dhe shitja e pasurive që përbëjnë aktivin e qëndrueshëm të Shoqërisë;

e. themelimi nga ana e Shoqërisë "**TBI Consulting**" Sh.p.k të shoqërive ose pjesëmarrja në shoqëri të tjera të krijuara, ose për t'u krijuar;

f. marrja e huave afatmesme, afatgjata, dhënia e dorëzanive ose e garancive të tjera, kur këto të fundit tejkalojnë veprimitarinë e zakonshme të Shoqërisë;

g. negocimi, përfundimi a ndryshimi i çdo kontrate me afat mbi 5 vjet ose për një shumë detyrimesh vjetore mbi 10 milionë lekë.

h. përcaktimi i kritereve për diskutimin, përfundimin dhe ndryshimin e kontratës së punësimit me punonjësit;

j. si dhe ato vendime ose masa që e kapërcejnë veprimitarinë e zakonshme të Shoqërisë dhe që janë të tillë që mund të sjellin ndryshime në objektin e Shoqërisë.

20.5. Administratori mund t'u delegojë një pjesë të kompetencave të tij, që ai i gjykon të dobishme tek një ose disa persona të tjerë që kryejnë funksione teknike në aktivitetin e Shoqërisë.

20.6. Administratori mund t'u delegojë personave të tjerë ortakë ose jo, disa nga kompetencat e tij për ushtrimin e funksioneve të veçanta. Administratori nuk mund të delegojë tërësinë e kompetencave të tij.

## **NENI 21** **Administrimi i Shoqërisë nga disa Administratorë**

21.1. Asambleja e Ortakëve në çdo moment, mund të vendosë që Administrimi i Shoqërisë "**TBI Consulting**" Sh.p.k të kryhet nga disa Administratorë.



21.2. Ne kete rast, maredheniet midis administratoreve, kompetencat, te drejtat dhe detyrimet e secilit mund tē rregullohen ne rregullore tē veçantë ose tē parashikohen nē vendimin e Asamblesë së Ortakëve.

21.3. Asambleja e Ortakëve mund te kufizoje kompetencat dhe te drejtat e secilit Administrator dhe/ose te vendose qe ata te ushtrojne kompetencat e tyre me vendime te perbashketa dhe te drejte firme te perbashket ose secili prej Administratorëve tē ketë kompetenca tē veçanta.

21.4. Administrimi i Shoqërisë "**TBI Consulting**" Sh.p.k nga disa administratorë i jep tē drejtën secilit prej tyre tē kundërshtojë cdo operacion tē projektuar nga Administratori tjetër përparr se operacioni tē ketë përfunduar.

21.5. Kundërshtimi i një Administratori pér një ose disa operacione që kërkon tē kryejë Administratori tjetër, është një akt që e çliron atë nga përgjegjësia ndaj Ortakëve pér veprimet e Administratorit tjetër.

21.6. Kundërshtimi i shfaqur nga një Administrator ndaj veprimeve tē Administratorit tjetër, është pa pasoja ose efekte ndaj tē tretëve, përveç rastit kur është provuar se tē tretët nuk kanë pasur dijeni pér këtë përgjegjësi tē përbashkët tē Administratorëve.

21.7. Në rast se disa administratorë janë bashkëfajtorë pér veprimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë, masa e kontributi që duhet tē paguajë secili pér shlyerjen e dëmit, vendoset nga gjykata.

### **NENI 22 Të drejtat e Administratorit**

22.1. Administratori pér punën e kryer shpérblehet, por funksionet e tij mund tē jenë pa shpérblim nëse ai ka shprehur vullnetin e tij pér këtë klauzolë.

22.2. Shpérblimi i Administratorit përcaktohen me vendim tē Ortakëve ose nē Aktin e Emërimit tē tij dhe mund tē jetë ose nē shumë fikse osë nē përpjestim me tē ardhurat e Shoqërisë "**TBI Consulting**" Sh.p.k

22.3. Administratori ka tē drejtën e rimbursimit tē shpenzimeve që ai kryen gjatë ushtrimit të funksioneve tē tij.

### **NENI 23 Pergjegjesitë e Administratorit**

23.1. Në marrëdhënie me tē tretët, Administratori është përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë "**TBI Consulting**" Sh.p.k.

23.2. Çdo ortak joadministrator ka tē drejtë dy herë nē vit t'i paraqesë me shkrim Administratorit disa pyetje pér ato probleme që mendon se përbëjnë shqetësim pér veprimtarinë e shoqërisë. Pér pyetjet e bëra Administratori është i detyruar t'i përgjigjet me shkrim.

23.3. Shoqëria merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga veprimet e administrimit të Shoqërisë tē kryera nga Administratori edhe kur këto veprime nuk përfshihen nē objektin e shoqërisë. Shoqëria "**TBI Consulting**" Sh.p.k nuk merr përsipër pasojat ndaj tē tretëve kur ajo provon se tē tretët e dinin që akti i Administratorit e kalonte objektin e Shoqërisë ose kur tē tretët nuk mund ta injoronin këtë fakt nē rrrethanat e krijuara.

23.4. Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj Shoqërise apo te treteve per:

- a. shkelje tē ligjeve;
- b. pér shkelje tē Statutit, apo
- c. pér faje tē kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.



23.5. Mund te kerkohet perjegjesia civile e Administratorit në rastet e neglizhencës, pakujdesisë apo manovrave mashtruese, të cilat do të konsiderohen faje të kryera gjatë administrimit të Shoqërisë, të tilla si:

- a. porosi mjaft e madhe nga Administratori përmallra ose shërbime kur Shoqeria eshte deficitare;
- b. mungesa e mbikqyrjes mbi një bashkeadministrator i cili ka vjedhur fonde te Shoqerise;
- c. mosinformimi i Ortakeve per gjendjen financiare jo të mirë te Shoqerise;
- d. lidhja e një kontrate me kushte shumë te demshme per Shoqerine;
- e. dhenia te tretëve e komisioneve te fshehta;
- f. zbatimi i keq i një vendimi te Asamblee së Ortakëve;
- g. mospagimi i kuotave te sigurimeve shoqerore, kur gjendja e likuiditeteve te Shoqerise e mundesonte një gje të tillë,
- h. kembengulja per ta administratuar Shoqerine vetem, pikerisht duke refuzuar per te mbledhur Asamblijën e Ortakëve;
- i. kryerja e mashtrimeve tatimore;
- j. shfaqja e neglizhencës që ka sjelle denimin e shoqerise me demshperblim financier per konkurence te pandershme;
- k. si dhe çdo rast tjetër që përbën shkak për shkarkimin e tij sipas nenit 18 të këtij Statuti.

23.6. Nëqoftë se Administratori shkel një klauzolë të Statutit që kufizon kompetencat e tij të parashikuara në nenin 20, Asambleja e Ortakëve mund t'i kërkojnë atij zëvendësimin e dëmit të shkaktuar nga ky veprim. Mosnjohja e Statutit përbën një arsyë të drejtë për shkarkimin e Administratorit dhe privimin nga e drejta e dëmshperblimit financier për shkarkimin.

23.7. Padia që njeh dhe vendos për përgjegjësinë civile të Administratorit për veprimet e kryera mund të ngrihet nga një ortak që vepron individualisht ose nga një grup ortakesh. Ortaku ose Ortakët paditës kanë të drejtë të ndjekin në rrugë gjyqësore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar Shoqërisë "**TBI Consulting**" Sh.p.k nga veprimet e Administratorit, përfshirë edhe dëmshperblimin financier, nëse është e nevojshme. Në një rast të tillë, demshperblimi financier i vendosur nga gjykata i takon Shoqerise dhe jo paditesve.

23.8. Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht, ortakët individualisht ose në grup, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër Administratorit.

23.9. Administratori është i detyruar të ruajë dhe të mos bëjë të ditur mënyrën e vendimmarres dhe të veprimit në Shoqërinë "**TBI Consulting**" Sh.p.k duke trajtuar në mënyrë konfidenciale, informacionin dhe sekretet e shoqërisë, veçanërisht ato industriale dhe të biznesit, për të cilat ai ka marrë dijeni gjatë kryerjes së detyrës së tij. Ky detyrim i Administratorit mbetet i vlefshëm edhe pas largimit të tij nga funksioni në Shoqërinë "**TBI Consulting**" Sh.p.k.

**NENI 24**  
**Eksperти kontabel i autorizuar**

24.1. Kontrolli i veprimtarise se Shoqerise kryhet nga një ekspert kontabel i autorizuar (person fizik apo Shoqeri).



24.2. Eksperti Kontabël caktohet me vendim te Asamblese së Ortakëve për një periudhë prej 6 vitesh financiare.

24.3. Në Vendimin e Asamblesë së Ortakëve për emërimin e Ekspertit Kontabël, përcaktohen edhe kompetencat, funksionet, detyrimet, përgjegjësia, zëvendësueshmëria, tërheqja, shkarkimi dhe shpérblimi tij.

24.4. Në çdo rast, Eksperti Kontabël i autorizuar lajmërohet njëkohësisht ose më përpala se ortakët, për mbajtjen e mbledhjeve të Asamblesë së Ortakëve ose konsultimeve me shkrim, si dhe lejohet të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë.

#### **IV. VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, NDARJA E FITIMIT**

##### **NENI 25 Viti Financiar**

25.1. Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor dhe perputhet me vitin kalendarik. Perjashtimisht viti i pare fillon ne diten e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar te Gjykates dhe perfundon ne 31 dhjetor.

##### **NENI 26 Llogarite Vjetore**

26.1. Me mbylljen e vitit financiar, administratori i shoqerise ben inventarin dhe llogarite vjetore ne perputhje me legjislacionin mbi kontabilitetin. Bilancit i bashkengjiten: nje situacion mbi garancite e dhena nga shoqeria dhe nje situacion mbi sigurimet e bera nga shoqeria.

26.2. Dokumentet e permendura ne paragrafin e pare te ketij nenii vihen ne dispozicion te eksperteve kontabel te autorizuar ne seline e shoqerise te pakten nje muaj perpara mbledhjes se asamblese se ortakeve.

26.3. Miratimi i dokumenteve mbi veprimtarine vjetore te shoqerise behet nga Asambleja e Ortakeve brenda nje afati prej 6 muajsh nga dita e mbylljes se vitit financiar.

##### **NENI 27 Fitimi**


27.1. Fitimi ose kur eshte rasti humbja e ushtrimit financiar percaktohet nga diferenca midis te ardhurave dhe shpenzimeve te ushtrimit, ne pajtim me rregullat e parashikuara ne legjislacionin mbi kontabilitetin

27.2. Fitimi i ushtrimit mund te destinohet per te krijuar e plotesuar rezervat e shoqerise ose per t'ju shperndare ortakeve.

27.3. Ne rastin e nje humbjeje Asambleja qe miraton llogarite duhet te vendose per mbulimin e humbjes.

##### **NENI 28 Rezervat**

28.1. Rezerva e domosdoshme nuk mund te perdoret as per tju shperndare ortakeve as per shlyerjen apo riblerjen e pjeseve nga shoqeria.



28.2. Ajo perdoret ne rastin e humbjeve kur keto humbje nuk mund te mbulohen (thithen) nga rezerva te tjera.

28.3. Ne rastin kur shoqeria nuk ka te mbartura humbje nga ushtrimet e meparshme masa e fitimeve mbi te cilen llogaritet rezerva e domosdoshme eshte shuma e fitimit te ushtrimit financiar te mbyllur.

28.4. Ne rastin kur shoqeria ka te mbartura humbje nga ushtrimet e meparshme masa e fitimeve mbi te cilen llogaritet rezerva e domosdoshme eshte shuma e fitimeve te mbetura pas zbritjes se humbjeve te mbartura.

28.5. Heqja nga fitimet per krijimin e rezerves ose per te ushqyer rezerven e domosdoshme eshte te pakten 1/20 e mases se fitimeve. Kjo heqje nuk eshte e detyrueshme kur rezerva e domosdoshme arrin 1/10 e kapitalit themeltar.

#### **NENI 29 Shperndarja e Fitimit**

29.1. Fitimi qe do te shperndahet perbehet nga fitimi i ushtrimit perkates te cilil:

- a. i zbriten humbjet e mbartura dhe shumat qe hiqen per rezervat
- b. i shtohen fitimet e mbartura.

29.2. Fitimet ndahen ndermjet ortakeve ne perputhje me perqindjen e kapitalit themeltar qe ka secili ortak.

#### **NENI 30 Dividentet**

30.1. Asambleja e per gjithshme mund te vendose shperndarjen e dividenteve vetem pasi:

- a. nga njera ane te kete miratuar llogarite vjetore;
- b. nga ana tjeter te kete percaktuar shumen qe do te shperndahet.

#### **NENI 31 Paradheniet per dividentet**


31.1. Paradhenie per dividente jane shumat qe u jepen ortakeve perpara miratimit te llogarive vjetore dhe caktimit nga asambleja te dividentit perfundimtar. Keto paradhenie jane te ligjshme, por duke respektuar kerkesat e nenit 215 te ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe konkretisht me kusht qe :

- a. shoqeria vec rezerves se domosdoshme e kete ne dispozicion rezerva me nje shume te pakten te njejtë me paradheniet e shperndara, ose qe nje raport vertetimi i bere nga nje ekspert kontabel i autorizuar te beje fitime neto me te medha se shuma e paradhenieve.
- b. shperndarja e paradhenieve duhet te vendoset nga administratori i cili duhet te caktoje edhe daten e kthimit.

#### **NENI 32 Vendimi per humbjet**

32.1. Ne rastin kur rezultati i ushtrimit te mbyllur eshte humbje, asambleja e per gjithshme mund te vendose:

- a. ose mbartjen e kesaj humbjeje ne ushtrimin e ardhshem, duke kaluar ne nje llogari te vecante "humbje te mbartura"



b. ose pastrimin e saj nga rezervat, duke perfshire edhe rezerven e domsdochme.  
32.2. Vetem kur humbjet e mbartura te jene pastruar teresisht mund te rifilloje shperndarja e fitimeve.

**NENI 33**  
**Detyrimi per te perballuar humbjet**

Detyrimi per te perballuar humbjet eshte perpjestimor me kontributet e seicilit ortak. Cdo marreveshje qe parashikon perjashtimin e nje ortaku nga perballimi i humbjeve eshte i pavlefshem. Nese shoqeria prishet dhe vihet ne likuidim, atehere likuidatori eshte i detyruar te shlyeje te paret kreditoret e saj.

**NENI 34**  
**Publikimi**

34.1. Cilido qofte vendimi i marre nga ortaket, prishje apo vazhdimi i shoqerise, ai duhet te publikohet ne nje gazete te autorizuar per publikime ligjore dhe te regjistrohet ne regjistrin tregtar.

**NENI 35**  
**Bilanci**

35.1. Bilanci vjetor i shoqerise nxirret brenda 31 Marsit te viti pasardhes.

**V. PRISHJA E SHOQERISE DHE LIKUIDIMI**

**NENI 36**  
**Humbja e gjysmes se kapitalit.**


36.1. Ne rast se kapitalet e veta te shoqerise per shkak te humbjeve te konstatuara ne dokumentet kontabel rezultojne me te uleta se gjysma e kapitalit themeltar, atehere konsultimi i ortakeve eshte i detyrueshem.

36.2. Ortaket duhet te vendosin, mbi mundesine e prishjes se shoqerise brenda 4 muajve nga data e miratimit te llogarive qe pasqyrojne kete humbje. Megjithate edhe konsultimi me shkrim midis ortakeve nuk perjashtohet.

36.3. Vendimi merret ne te njejten menyre si per kryerjen e ndryshimeve ne statut.

**NENI 37**  
**Rregullimi i gjendjes**

37.1. Neqofte se ortaket kane vendosur ta mbajne shoqerine atehere ata kane nje afat prej nje viti nga data e mbylljes se ushtrimit kur eshte konstatuar gjysma e humbjes se kapitalit per te plotesuar kapitalet e veta.



37.2. Neqoftese plotesimi i kapitaleve te veta nuk arrihet atehere shoqeria duhet te procedoje ne zvogelimin e kapitalit ne nje vlere jo me te vogel se ajo e humbjeve qe kane mbetur te pambuluara nga rezervat. Por duhet mbajtur parasysh qe kapitali nuk mund te jetë nen minimumin e kerkuar nga neni 38 i ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare".

**NENI 38**  
**Kerkimi nga te tretet i prishjes se shoqerise**

38.1. Cdo person i interesuar mund te kerkoje ne rruge gjyquesore prishjen e shoqerise kur:

- a. administratoret ose eksperti kontabel i autorizuar nuk kane marre iniciativen per konsltimin e ortakeve.
- b. kur ortaket nuk kane marre asnjë vendim
- c. kur nuk eshte realizuar as plotesimi i kapitaleve te veta dhe as zvogelimi i tij.

**NENI 39**  
**Likuidimi**

39.1. Shoqeria prishet me vendim te Asamblese me unanimitet dhe ne perputhje me dispozitat ligjore qe veprojne ne Republiken e Shqiperise.

**VI. DISPOZITAT E FUNDIT**

**NENI 40**  
**Mosmarreveshjet**

40.1. Per te gjitha mosmarreveshjet brenda shoqerise qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, organi komponent do te jetë Gjykata e rrithit gjyqesor Tirane.

40.2. Ky Statut redaktohet ne 5 kopje origjinale ne gjuhen shqipe dhe nenshkruehet me vullnetin e tyre te lire nga ortaket themelues.


**ORTAKET:**

**ARTAN BOZO**

**OLSI IBRO**

**ISMAIL KADIU**

**KETRIN TOPÇIU**

  
Artan Bozo Olsi Ibro

  
Ismail Kadiu

  
Ketrin Topciu

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE  
NR. 5270 REP.  
NR. 378 KOL.



*Tatjana e pavarur*

**V E R T E T I M**

Ne Tirane, sot ne date 13.11.2006 (dymije e gjashtc) para meje Noteres Lindita KOKONA, anetare e Dhomës se Noterive Tirane, me zyre ne Bulevardin "Gjergj Fishta", u paraqiten personalisht me cilesine e ortakeve themelues te Shoqerise "TBI Consulting" Shpk:

**Z.ARTAN BOZO**, datelindja 28.08.1969, banues ne Tirane, mbajtes i pasaportes Nr.Z0772452.

**Z.OLSI IBRO**, datelindja 01.03.1978, banues nc Tirane, mbajtes i pasaportes Nr.Z0317520.

**Z.ISMAIL KADIU**, datelindja 26.03.1961, banues ne Tirane, mbajtes i pasaportes Nr.Z1560583.

**Znj.KETRIN TOPÇIU**, datelindja 12.11.1968, banuese ne Tirane, mbajtese e leternjoftimit Nr.NF 475429, madhore, me zotesi te plete juridike per te vepruar, te cilet nenshkruan para meje, me vullnetin e tyre te lire Statutin e Shoqerise "TBI Consulting" Shpk, dhe une noterja vertetoj sipas ligjit nenshkrimin e tyre.

Baza Ligjore : Ligji "Per Noterine".

NOTER  
LINDITA KOKONA

*Meloush*